



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
THE MUNICIPALITY OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE-SUVA REKA



S T A T U T I
I
BIBLIOTEKËS SË QYTETIT “HAJDIN BERISHA”
NË SUHAREKË

Suharekë-2023

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 12, lidhur me nenin 18, të Ligjit Nr. 04/L-097 për Bibliotekat “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 09/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-121 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2019”, e konform nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2, dhe me nenin 47, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë ne mbledhjen e mbajtur me datën 28.02.2023 miratoi;

STATUTIN E BIBLIOTEKËS SË QYTETIT “HAJDIN BERISHA” NË SUHAREKË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME;

Neni 1 Qellim

Me këtë Statut rregullohet statusi i Bibliotekës së qytetit “Hajdin BERISHA” në Suharekë, (në tekstin e mëtejme Biblioteka), emërtimi, selia, veprimtaria, përfaqësimi, prezantimi, menaxhimi, sistematizimi i brendshëm i stafit, autorizimet dhe mënyra e vendosjes së organeve të caktuara të Bibliotekës, organizimi i punës dhe planifikimi i zhvillimit, mënyra e sigurimit të mjeteve financiare, çështje të tjera të rëndësishme lidhur me kryerjen e veprimtarisë të Bibliotekës.

Neni 2 Statusi i bibliotekës

2.1 Biblioteka është institucion kulturor, edukues e informues që grumbullon, pasuron, përpunon, mirëmban dhe ruan koleksionet e veta nga fushat e ndryshme të krijimtarisë dhe të veprimtarisë intelektuale me qëllim që t’i bëjë të njohura dhe t’ua vë në dispozicion shfrytëzuesve për t’i lexuar, hulumtuar e studiuar dhe për t’i lënë trashëgim gjeneratave të ardhshme.

2.2 Biblioteka është pjesë përbërëse e rrjetit kombëtar, ndër komunal bibliotekar të Kosovës.

2.3 Biblioteka është nën mbikëqyrje administrative të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Mërgatës dhe Ministrisë për kulturë, rini dhe sport e në pajtim me Ligjin për Biblioteka dhe aktet tjera nënligjore.

2.4 Biblioteka është nën mbikëqyrje profesionale të Bibliotekës Kombëtare dhe Ministrisë për kulturë, rini dhe sport.

2.5 Themelues i Bibliotekës është Kuvendi i Komunës në Suharekë.

2.6 Komuna themelon me vendim të veçantë Bibliotekën, sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

2.7 Organet e qeverisjes komunale mbështesin dhe nxisin shërbimet bibliotekare, sigurojnë kushtet e nevojshme për punë dhe zhvillimin e bibliotekave të sektorit publik në përputhje me politiken e zhvillimit të kulturës, të shkencës, informacionit, arsimit, edukimit në nivel komunal e kombëtar.

2.9 Biblioteka regjistrohet në Regjistrin e Ministrisë së Kulturës.

Neni 3 Emërtimi Selia dhe Vula

3.1 Biblioteka e qytetit në Suharekë daton së punuari nga viti 1950, ndërsa nga data 24.03.2017, me vendimin 01-Nr-020-11840 të miratuar në Kuvendin e Komunës së Suharekës, Emërtohet Biblioteka e qytetit **“Hajdin BERISHA”**.

3.2 Selia e Bibliotekës së qytetit është në Rr. “Xhavit Bajraktari” në Suharekë.

3.3 Emërtimi i bibliotekës me shenjën e saj dalluese-llogon, duhet të vendoset në objektin e selisë dhe degëve ku ajo e zhvillon veprimtarinë.

3.4 Biblioteka posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si Biblioteka e qytetit **“Hajdin BERISHA”**.

3.5 Vula është në formë të rrumbullakët dhe ka dimension 3.5 cm (35 mm).

3.5.1 Rrethi i parë: Republika e Kosovës;

3.5.2 Rrethi i dytë: Komuna e Suharekës;

3.5.3 Rrethi i tretë: Biblioteka **“Hajdin BERISHA”** në Suharekë;

3.5.4 Në mes të vulës është logoja e bibliotekës “Libri i hapur”.

3.6 Biblioteka posedon vulën katrore, me dimensione 5.5 cm x 3 cm që përmban emërtimin, selinë dhe hapësirën për evidentimin e numrit dhe të datës së pranimit të dokumentit.

3.7 Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit, sipas këtij Statuti dhe të jetë në gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtar në Republikën e Kosovës.

3.8 Biblioteka e qytetit “Hajdin BERISHA” ka xhirollogarinë e vet në njërën prej bankave të licencuara në Republikën e Kosovës.

Neni 4 Veprimtaria e Bibliotekës

4.1 Biblioteka koordinon dhe mbikëqyrë punën profesionale të bibliotekave komunale në rajonin e vet, ndihmon pasurimin e fondeve me koleksione bibliotekare.

4.2 Grumbullon materiale bibliotekare të formateve të ndryshme nga të gjitha shkencat e dijes, i regjistron, përpunon, sistemon, ruan, mirëmban dhe i jep në shërbim të përdoruesve.

4.3 Ofron qasje në materialin bibliotekar për të gjithë përdoruesit, pavarësisht nga raca, kombësia, gjinia, mosha, besimi fetar, gjuha, paaftësitë fizike dhe informon e ndihmon ata në përdorimin e gjetjen e tyre.

4.4 Bashkëpunon në përpilimin e katalogut të përbashkët elektronik me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe e vë në dispozicion të përdoruesve të bibliotekës.

4.5 Bashkëpunon me bibliotekat në vend dhe jashtë vendit me mbështetje të Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë dhe të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

4.6 Organizon aktivitete kulturore dhe edukative në ambientet e saj siç janë: ekspozita të librit, promovime, tribuna, takime me krijues, orë letrare dhe veprimtari tjera bibliotekare.

4.7 Bashkëpunon me institucionet kulturore, shtëpitë botuese, shkollat dhe me komunitetin me qëllim të nxitjes së interesimit për librin dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

4.8 Përmes Web – faqes, katalogëve, fletushkave e formave tjera të informimit prezanton për publikun shërbimet dhe veprimtarinë e saj.

4.9 Përpilon dhe boton publikime profesionale si: katalogë, doracakë, fletëpalosje, revista etj, në pajtim me ligjin dhe aktet tjera nënligjore.

4.10 Harton dhe propozon projekte e programe për zhvillimin e rrjetit bibliotekar të bibliotekave që i mbikëqyr.

4.11 Bën huazimin dhe këmbimin e materialeve bibliotekare për t'i përmbushur nevojat dhe kërkesat e përdoruesve.

4.12 Mbledh informacione dhe materiale të nevojshme për rajonin ku vepron, të cilin e ruan dhe e vë në shërbim të përdoruesve.

4.13 Ushtron edhe veprimtari tjera në harmoni me Ligjin për biblioteka dhe aktet tjera nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 5

Përfaqësimi dhe Prezantimi

5.1 Bibliotekën e qytetit "Hajdin Berisha" e përfaqëson dhe e prezanton Drejtori.

5.2 Drejtori mund t'ia bartë personit tjetër autorizimin për përfaqësimin e Bibliotekës në kufijtë e autorizimeve të tij.

5.3 Drejtori në mungesë të tij, mund të autorizojë personin tjetër, për nënshkrimin e dokumentacionit financiar dhe dokumentacionit tjetër.

Neni 6

Organizimi i Bibliotekës

6.1 Me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të mira në përmbushjen e rolit, të drejtave, të detyrave të punës dhe veprimtarisë bibliotekare, e në përputhje me procesin e punës, biblioteka është e organizuar në sektorë dhe degë si më poshtë.

6.2 Sektorët e bibliotekës janë:

6.2.1 Sektori i të Rriturve

6.2.2 Sektori i Fëmijëve

6.2.3 Sektori i Periodikut me Sallë të leximit

6.2.4 Sektori i trashëgimisë dhe ruajtjes së librit

6.2.5 Sektori i hulumtimit dhe zhvillimit bibliotekar

6.2.6 Sektori pasurimit dhe përpilimit të librit

6.2.7 Këndi ndërkombëtar dhe

6.2.8 Info-bibliobusi

6.3 Biblioteka në kuadër të saj, mund të ketë edhe degët e veta në rajonin ku vepron.

6.4 Në pajtim me programin e zhvillimit të veprimtarisë së vet, biblioteka mund të formojë njësi të reja organizative, përkatësisht sektorë dhe degë sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

6.5 Me Rregulloren për organizimin e brendshëm të bibliotekës rregullohet organizimi, mënyra e punës, pozitat dhe vendet e punës në Bibliotekë.

Neni 7

Themelimi i bibliotekës së re

7.1 Biblioteka, përkatësisht dega e bibliotekës mund të fillojë veprimtarinë nëse plotësohen këto standarde minimale:

7.1.1 ka hapësirën fizike;

7.1.2 ka mjedisin bibliotekar;

7.1.3 ka koleksionin fillestar;

7.1.4 ka pajisjet dhe personelin e kualifikuar;

7.1.5 ka siguruar financimin e veprimtarisë;

7.1.6 ka kushte për punë (higjienike, ekologjike etj);

Neni 8

Organet e bibliotekës

8.1. Organet e bibliotekës së qytetit “Hajdin Berisha” në Suharekë janë:

8.1.1 Drejtori dhe

8.1.3 Stafi profesional dhe administrativo-teknik i bibliotekës.

Neni 9

Drejtori i bibliotekës

- 9.1 Organizon dhe qeverisë me tërë veprimtarinë e bibliotekës dhe përgjigjet për organizimin dhe realizimin e detyrave dhe të funksionit të saj;
- 9.2 Organizon, mbikëqyrë dhe motivon punën e personelit dhe jep udhëzime e urdhëresa për punë;
- 9.3 Përfaqëson Bibliotekën e qytetit “Hajdin Berisha” në vend dhe jashtë vendit,
- 9.4 Është përgjegjës për ligjshmërinë në punën e Bibliotekës së qytetit “Hajdin Berisha” dhe degët e saj,
- 9.5 Është përgjegjës për miratimin e planit dhe të programit të punës dhe të zhvillimit të bibliotekës sipas dispozitave të këtij statuti dhe të ligjeve dhe akteve nënligjore tjera në fuqi.
- 9.6 Paraqet raporte përkatëse për rezultatet e punës, ecurinë e shërbimeve dhe përdorimin e buxhetit në Drejtorinë për kulturë, rini, sport dhe mërgatë.
- 9.7 Përcjellë problematikën e bibliotekës dhe merr masa për zgjedhje më të mira.
- 9.8 Vlerëson personelin në bazë të vlerësimit të punës profesionale dhe aftësive organizative.
- 9.9 Vendos për organizimin e brendshëm të bibliotekës në harmoni me rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizimin - organogramin e vendeve të punës.
- 9.10 Kryen edhe punë të tjera në përputhje me ligjin, me këtë Statut dhe me aktet e përgjithshme të Bibliotekës.

Neni 10

Zgjedhja e Drejtorit

- 10.1 Drejtori i bibliotekës zgjidhet me konkurs publik.
- 10.2 Drejtori i bibliotekës Komonale duhet të ketë se paku diplomë Universitare.
- 10.3 Mandati i drejtorit është katër (4) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes.
- 10.4 Vendimin për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Drejtorit të bibliotekës e nxjerr Kryetari i Komuna.

Neni 11

Pozita e të punësuarve në bibliotekë

- 11.1 Stafi profesional i bibliotekës përzgjidhet në përputhje me përgatitjen profesionale bibliotekare.
- 11.2 Çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrat e të punësuarve në bibliotekë rregullohen në pajtim me ligjin e punës, Ligjin për zyrtaret publik dhe dispozitat e tjera përkatëse ligjore, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në pajtim me këtë statut.
- 11.3 Punëtorët e Bibliotekës duhet të jenë të informuar me të gjitha ecuritë e punës në Bibliotekë.

Neni 12

Programi i punës dhe i zhvillimit të bibliotekës

12.1 Programin-planin e punës dhe Raportin vjetor të punës së Bibliotekës e propozon Drejtori i bibliotekës ndërsa e miraton Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë në Komunën e Suharekës.

12.2 Programi- plani i punës vjetor i dorëzohet në fund të gjashtëmuajorit të dytë të vitit vijues për vitin e ardhshëm.

Neni 13

Mënyra e financimit

13.1 Mjetet financiare për kryerjen e veprimtarisë së bibliotekës komunale sigurohen nga:

13.2 Buxheti i Komunës.

13.3 Buxheti i Ministrisë përkatëse për Kulturë, nga buxheti i vet, përmes konkursit vjetor për projekte, financon projekte të bibliotekave komunale me fondin prej pesë përqind (5 %) të buxhetit të përgjithshëm vjetor të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës.

13.4 Biblioteka komunale mund të financohet edhe nga burimet tjera financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi.

13.5 Drejtori është përgjegjës për realizimin e planit financiar të Bibliotekës.

13.6 Drejtori ia paraqet raportin financiar për vitin e kaluar themeluesit përmes Drejtorit të Drejtorisë për kulturë, rini, sport dhe mërgatë.

Neni 14

Aktet e përgjithshme të bibliotekës

14.1 Përmes akteve nënligjore administrative, të nxjerra nga Biblioteka, rregullohet në mënyrë të përgjithshme veprimtaria bibliotekare, si dhe çështja e zbatimit të ligjshmërisë dhe punës në Bibliotekë.

14.2 Aktet nënligjore administrative miratohen me nënshkrim nga Drejtori Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, në bashkëpunim me Drejtorin e bibliotekës, me këtë statut dhe me dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 15

Puna publike e bibliotekës

15.1 Puna e Bibliotekës është publike.

15.2 Statuti, Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe mënyra e punës së Bibliotekës si dhe aktet e tjera të përgjithshme shpallen në tabelën e shpalljeve të Bibliotekës.

15.3 Biblioteka njofton opinionin publik për organizimin e punës së Bibliotekës, kushtet e punës, mënyrën e ofrimit të shërbimeve, kryerjen e punëve nga veprimtaria e vet, orarin e punës me lexues (para e pas dite dhe të shtunave) përmes medieeve dhe formave tjera të komunikimit.

15.4 Informacione dhe shënime për kryerjen e veprimtarisë ose qasje të lirë në dokumentacionin e bibliotekës, medieeve dhe personave tjerë mund t'ua ofrojë vetëm Drejtori ose personi të cilin Drejtori e autorizon për këtë qëllim.

Neni 16

Bashkëpunimi me sindikatën

16.1 Organizimi Sindikal në Bibliotekë është i pavarur.

16.2 Biblioteka është e obliguar që të sigurojë kushte për punën e sindikatës, t'ia vë në dispozicion informacionet të cilat i nevojiten për kryerjen e detyrës së tij/saj, si dhe t'i mundësojë qasje në aktet dhe dokumentet lidhur me realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punonjësve nga marrëdhënia e punës.

Neni 17
Mbrojtja e sekretit të punës

17.1 Shënime sekrete konsiderohen shënimet të cilat Drejtori në përputhje me dispozitat ligjore pozitive dhe aktin e përgjithshëm i përcakton si sekrete, si dhe të gjitha shënimet që organi publik ose personi tjetër juridik ia kumton Bibliotekës si sekrete.

17.2 Punonjësit e Bibliotekës janë të obliguar që të ruajnë shënimet që konsiderohen si sekrete pavarësisht nga mënyra se si janë njoftuar për ato shënime ose si janë siguruar ato përkatësisht nga mënyra e arritjes së mundësisë së qasjes në ato shënime.

17.3 Obligimi për ruajtjen e shënimeve sekrete vazhdon të vlejë edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Bibliotekë, në përputhje me dispozitat ligjore pozitive.

Neni 18
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

18.1 Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti nuk vlen më Statuti i mëparshëm .

18.2 Aktet e përgjithshme të Bibliotekës do të harmonizohen me dispozitat e këtij Statuti në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes së tij në fuqi të këtij Statuti dhe nuk mund të kanë fuqi retroaktiv.

Neni 19
Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin

Ky Statut mundë të ndryshohet dhe plotësohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë duke e dhënë arsyetimin nga propozuesi përkatësisht nga Drejtori i bibliotekës përmes Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgata të Komunës së Suharekës.

Neni 20
Epërsia me Ligjet dhe aktet tjera nënligjore

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të këtij Statuti dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-097 për Bibliotekat “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 09/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-121 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2019”, do të aplikohen dispozitat e ligjit dhe akteve tjera nënligjore.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky Statut hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr- 016-14455
Me date 28.02.2023



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI